



Qershor 2013

# Zëri i Grave Kosovare

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

## Bashkangjituni!

Takimi i Rregullt i RrGGK  
2 Shtator 2013

Retreat i RrGGK (Vetëm për  
anëtarët)  
Durrës, 3-6 Tetor 2013

## Në këtë numër

Takimi Rajonal i Vajzave në  
Kroaci.....2

Higjiena e Ushqimit Luan  
Rol në Gjetjen e Tregut për  
Produkte.....2

Filloi Fushata me Moton  
“Dëgjo zërin tim”.....2

Vajzat Aktiviste Mobilizohen  
në Mitrovicë.....3

Mbi 5000 Pjesëmarrës nga e  
Gjithë Bota Diskutojnë për  
të Drejtat Shëndetësore të  
Grave.....3

Anëtarët e RrGGK Takohen  
për Mbledhjen e Rregullt.....4



[Faqja në Facebook](#)  
[Grupi në Facebook](#)



[Lista e dërgesave të  
E-Lajmeve](#)

## Shpalsni aftësitë tuaja: Bëhuni pjesë e Garës së Fotografive të RrGGK, Fitoni 50€

Anëtare të RrGGK: a keni bërë ndonjë foto të mirë të aktiviteteve të OJQ-së tuaj së fundi? Dërgoni ato në [info@womensnetwork.org](mailto:info@womensnetwork.org) deri më 31 Gusht që të keni mundësinë të fitoni një shpërblim prej 50€. Fotoja dhe fjalia përshkruese fituese do të botohen në Buletin e RrGGK-së në muajin Shtator. \* Vetëm anëtarët e RrGGK kanë të drejtë të aplikojnë.

## RrGGK Reagon kundër Gjuhës së Urrejtjes

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) ka mbështetur reagimin dhe kërkesat e bëra nga Grupi i Grave Deputete të Parlamentit të Kosovës lidhur me gjuhën denigruese, poshtëruese, fyese dhe të pa moralshme që Imam Irfan Salihu ka përdorur kundër grave kosovare, në xhaminë Suzi Zerrini në Prizren. RrGGK konsideron se deklarata e Imam Irfan Salihut është shkelje e të drejtave dhe lirive të njeriut. Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton “të drejtat e secilit qytetar, liritë civile dhe barazi para ligjit për të gjithë qytetarët.” (kliko [këtu](#) për kumtesën e plotë).

## Anëtarët Bëjnë Foto në Gërmi

Me 28 Maj, në Parkun Kombëtar të Gërmisë, anëtarët e RrGGK morën pjesë në një [trajnim për fotografi](#), të organizuar me kërkesat e anëtareve. Trajnimi ishte në të njëjtën kohë relaksues dhe informativ.

Pjesëmarrëset mësuuan për elementet që duhet të konsiderojnë kur duan të bëjnë fotografi të mira, siç janë drita, reflektimi, veprimi, kompozicioni dhe dhe se kur duhet të merret leja për të fotografuar.

“Ky trajnim ishte shumë i nevojshëm,” pohon Sylbije Sahiti nga OJQ “Parajsa Jonë”. “Na ka mësuar se si të bëjmë foto të mira dhe tani ne mund t’i shfaqim më mirë aktivitetet dhe ngjarjet e OJQ-së tonë.” Përfaqësueset e OJQ-ve i vunë në përdorim njohuritë e tyre duke bërë fotografi në ambient të mbyllur dhe të hapur.

“Ne mësuam shumë sot, por njëkohësisht edhe u argëtuam,” shton Ganimete Tolaj nga OJQ [Mentor Tolaj NDERI](#). “Tema e trajnimit dhe vendi ku është mbajtur janë shumë të nevojshme dhe argëtuese.”



Anëtarët e RrGGK, stafi fotografohen në fund të trajnimit të mbajtur në Parkun Kombëtar të Gërmisë më 28 Maj.

## Takimi Rajonal i Vajzave në Kroaci

Me 7-11 Qershor vajzat nga Kosova dhe Serbia janë takuar në Split, Kroaci. Atyre iu bashkangjitën edhe vajzat nga Kroacia, Armenia dhe Azerbejgani. Vajzat diskutuan të drejtat e LGBT, si dhe shkëmbyen informata e përvoja. Ato poashtu morën pjesë në Paradën për të Drejtat e LGBT.

Që nga viti 2011, [Kvinna till Kvinna \(KtK\)](#) përmes vizitave studimore ka mbështetur fuqizimin e vajzave nga Kosova dhe Serbia. Kjo ishte vizita e katërt e këtij lloji, e vizitat paraprake janë mbajtur në Izrael/Palestinë, Kosovë dhe Serbi.

Vizitat studimore kanë krijuar miqësi të forta në mes të pjesëmarrëseve. “Ne tani kemi dikë në Kosovë dhe vajzat nga Kosova kanë dikë në Serbi me të cilët mund të kontaktojnë dhe të bashkëpunojnë, pa u ballafaquar me problemet në mes të dy vendeve tona,” tha një pjesëmarrëse nga Serbia.

Vajzat nga rajoni tashmë kanë filluar bashkëpunimin në iniciativa të përbashkëta (klikoni [këtu për më shumë informata](#)). Në mesin e këtyre iniciativave, RrGGK për këtë vit, ka filluar Iniciativën për Fuqizimin e Vajzave me mbështetje të KtK. Ju që jeni të interesuara të kontribuoni në fuqizimin e vajzave në Kosovë mund t’i bashkangiteni [grupit](#) tonë.



*Pjesëmarrëset diskutojnë iniciativa që do të çonin në fuqizimin e vajzave.*

## Higjiena e Ushqimit Luan Rol në Zbulimin e Tregut për Produkte

Të siguruarit e përgatitjes higjienike të produkteve ushqimore është hapi i parë që gratë duhet të ndërmarrin gjatë përgatitjes së produkteve të tyre për treg. Për këtë arsye, OJQ *Parajsa Jonë* ftoi 20 gra në trajnimin për higjienën e ushqimit në fshatin Krojmir, më komunën e Lipjanit. Tema zgjoi aq shumë interesim sa që më shumë se 43 gra të moshave të ndryshme morën pjesë në këtë trajnim.

Pjesëmarrëset diskutuan lidhur me higjienën e ushqimit, përcaktimi i temperaturës së duhur për ushqim, shmangia e përhapjes së sëmundjeve, pasterizimi i ushqimit, blerja e produkteve të papërpunuara dhe dërgesa e produkteve finale.

Hanifja, njëra nga pjesëmarrëset, ofroi kopshtin e saj për mbajtjen e trajnimit. “Jam shumë e lumtur që të ofroj këtë hapësirë për gratë,” tha ajo. “Është e vështirë për gratë që të dalin nga shtëpitë e tyre. Ky është një justifikim i arsyeshëm për ato që të dalin nga rutina e tyre e përditshme.”

Sylbije Sahiti, Drejtoreshë Ekzekutive e *Parajsa Jonë* aktivisht merr pjesë në panairë të organizuara nëpër Kosovë.



*Sylbije Sahiti nga Parajsa Jonë flet për higjienën e ushqimit.*

Ajo ndau eksperiencën e saj, duke i inkurjuar pjesëmarrëset që të ndërmarrin iniciativa për të fituar të holla dhe për të fuqizuar veten ekonomikisht. “Mos keni turp ose frikë që të ndani idetë tuaja dhe të bëni ëndërrat tuaja realitet,” iu tha Sylbija grave që ishin mbledhur në karrike plastike në kopsht. “Kur fillova së pari këtë iniciativë, nuk kisha mbështetje nga familja ime. Burri im nuk mendonte se unë mund t’ia dalë. Megjithatë, tani ai ka parë suksesin dhe është shumë mbështetës. Tani unë mund të siguroj të ardhura për familjen time dhe unë besoj se secila nga ju keni ide unike, mund të jeni të suksesshme dhe të fitoni të holla për veten dhe për familjen.”

## Filloi Fushata me Moton “Dëgjo zërin tim”

Në kuadër të fushatës “Dëgjo zërin tim”, [Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës \(QKRMT\)](#) e mbështetur nga Ministria e Integritimit Evropian në Prishtinë, shfaqti më 28 Qershor në kinemanë ABC dokumentarin me të njëjtin titull, i cili u kushtohet grave që kanë mbijetuar dhunën seksuale gjatë luftës në Kosovë. Filmi është realizuar nga kompania ASHA.

Në dokumentar shfaqen rrëfimet rrëqethëse dhe të vërteta të njëres nga të mbijetuarat. Filmi poashtu përfshin personalitete të njohura që shprehin opinionet e tyre, si: Tony Blair, Adem Demaçi, Myftiu Naim Tërnava, Ministria e Integritimit Evropian Vlora Çitaku, Prof. Ismet Salihu nga Instituti për Krime Luftë, Drejtoresha Ekzekutive e RrGGK Igballe Rogova dhe Drejtoresha Ekzekutive e QKRMT Feride Rushiti - të gjithë njohës të mirë të rrethanave dhe pasojave të këtyre krimeve të rënda të kryera gjatë luftës në Kosovë.

## Vajzat Aktiviste Mobilizohen në Mitrovicë

RrGGK organizoi një takim të [Iniciativës për Fuqizimin e Vajzave \(IFV\)](#) më 30 Maj në Mitrovicë ku morën pjesë rreth 25 vajza nga OJQ dhe institucione të ndryshme.

Vajzat diskutuan për problemet dhe çështjet me të cilat ato përballen në jetën e tyre të përditshme në Mitrovicë dhe strategjitë e tyre për të tejkaluar këto dukuri, përfshirë çasjen e vajzave në edukim, martesat e hershme, konfliktin ndërmjet gjeneratave dhe vështirësitë për tu përfshirë në pozita vendim-marrëse.

“Ky takim na ofroi ide të qarta për tejkalimin e vështirësive me të cilat ne si vajza përballemi sot,” tha një pjesëmarrëse.

“Poashtu na mësoi se sa e rëndësishme është që të mblidhemi më shpesh dhe të shkëmbejmë përvoja.”

Vajzat besojnë se hapi i parë drejt tejkalimit të këtyre problemeve është ngritja e vetëdijes në mes të vajzave dhe gjeneratave të vjetra, si dhe organizimi i shkëmbimeve të përvojave ndërmjet gjeneratave. Ato u inkurajuan që të vazhdojnë të mendojnë për ide dhe mënyra të zgjidhjes së çështjeve me të cilat ato përballen. Ato do të sjellin idetë e tyre për diskutim në takimet e radhës.

IFV doli nga interesimi i anëtarëve të RrGGK për të çuar përpara qëndrueshmërinë e organizimit të grave në Kosovë. Ajo ka për qëllim të përfshijë më shumë vajza në lëvizjen e grave të Kosovës duke i fuqizuar ato që të avokojnë për shqetësimet dhe nevojat e tyre.

Ky takim erdhi pas diskutimeve paraprake të mbajtura në Prizren dhe Gjilan. IFV mbështetet nga Kvinna till Kvinna.



*Vajzat punojnë në grupe për të adresuar shqetësimet dhe nevojat e tyre gjatë takimit fillestarë të IFV të organizuar nga RrGGK në Mitrovicë.*

## Mbi 5000 Pjesëmarrës nga Gjithë Bota Diskutojnë për të Drejtat Shëndetësore të Grave

Rreth pesë mijë pjesëmarrës nga gjithë bota morën pjesë në [Konferencën e Tretë Globale 2013](#) të organizuar nga Women Deliver më 28-30 Maj, në Kuala Lumpur, Malajzi.

Krerë të qeverive, politikbërës, profesionistë të shëndetësisë, përfaqësues të OJQ-ve, udhëheqës të korporatave dhe përfaqësues të mediave botërore nga 150 vende të botës u mblodhën për të diskutuar çasjen e grave në shërbime shëndetësore. Shumë pjesëmarrës vinin nga Afrika, Amerika Latine dhe Azia. Shumë pak prej tyre vinin nga Europa, por në mesin e tyre ishte Mimoza Paçuku, Koordinatorë e Projektit të RrGGK për [Fondin e Grave të Kosovës](#) (FGK).

“Isha e lumtur që po përfaqësoja Kosovën në ngjarjen më të madhe botërore të dekadës të organizuar mbi shëndetin,” tregon ajo.

Pjesëmarrësit e Konferencës ishin të ndryshëm, jo vetëm nga kombësia por edhe nga gjinia.

“Ne konferencën e Women Deliver, në mesin e 5,000 feministëve 40% ishin burra,” shprehet Mimoza. “Isha e befasuar nga angazhimi dhe ndërgjegjësimi i tyre për barazinë. NE KEMI LËVIZUR përpara!”

Mimoza ishte në mesin e [100 Liderëve të Rinjë](#) që morën pjesë në konferencë. Për gjatë një viti para konferencës, këta liderë të rinjë vijuan kurse elektronike mbi shëndetin, avokimin dhe komunikimin medial; këmbyen mendime; dhe diskutuan përmes blogjeve rregullisht mbi çështjet e shëndetësisë në vendet e tyre. Mimoza u ftua vonë gjatë vitit që t'i bashkangjitet këtij grupi të përzgjedhur, por punoi trefishin e kohës që të kapë hapin dhe të përfshihet në diskutimet e tyre. Women Deliver ofruan hapësirë që këta liderë të rinjë të shprehin nevojat e tyre gjatë një Para-Konference të të Rinjëve më 27 Maj.

Pjesëmarrësit prezantuan çështjet me të cilat të rinjtë në vendet e tyre përballen tek udhëheqësit botërorë që sjellin ndryshime, përfshirë Kathy Calvin, Presidente dhe Kryeshefe Ekzekutive e [United Nations Foundation](#); Barbara Bush, bashkë-themeluese e [Global Health Corps](#); Kate Gilmore, Zëvendës Drejtoreshë Ekzekutive e [UNFPA](#); Joy Marini, Drejtor, [Corporate Contributions, Johnson & Johnson](#); Princesha e Holandës Princess Mabel (L e 2-të); dhe Princesha e Kurorës së Danimarkës Princesha Mary (C).



*Lakshmi Puri, Ndihmës-Sekretare e Përgjithëshme për Mbështetje Ndërqeveritare dhe Partneritete Strategjike Entitetin e Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Gruas (UN Women), udhëhoqi seancën plenare.*

## Anëtarët e RrGGK Takohen për Mbledhjen e Rregullt

Rreth 60 anëtare, anëtarë të stafit dhe mbështetës morën pjesë në takimin e rregullt të RrGGK të mbajtur më 7 Qershor në Prishtinë.

Fillimisht anëtarët e RrGGK dëgjuan përfundimet dhe rekomandimet e [Studimit Gjinor në Kosovë](#), i cili ekzaminoi implementimin e Ligjit mbi Barazinë Gjinore dhe Programit të Kosovës për Barazi Gjinore deri më sot. I ndërmarr nga dy ekspertë të pavarur në Nëntor – Dhjetor 2012, studimi ishte financuar nga [Swedish International Development Agency \(Sida\)](#) për të shpalosur strategjinë e saj të ardhshme në Kosovë dhe rajonin.

Duke përcjellë prezantimin, anëtarët e RrGGK kishin mundësi të komentojnë të gjeturat dhe të diskutojnë me përfaqësuesit e Sida-s Maria Melbing dhe Visare Gashi-Gorani, sfidat me të cilat përballen organizatat e udhëhequra nga gratë. Anëtarët e RrGGK ngritën shqetësime lidhur me çasjen e tyre në fonde dhe tendencat e fundit të donatorëve që të japin fonde përmes qeverisë. Anëtarët e RrGGK diskutuan se si kjo mund të ndikojë në pavarësinë e tyre dhe aftësinë për t'i mbajtur të përgjegjshëm zyrtarët qeveritarë.

Zn. Maria Melbing shprehu angazhimin e Sida-s për të vazhduar mbështetjen e saj për shoqërinë civile dhe për të mbështetur barazinë gjinore në Kosovë. Megjithatë, ajo tha që Sida vazhdon të diskutojë mekanizmin përmes të cilit një mbështetje e tillë do të ofrohet si pjesë e procesit të planifikimit strategjik të saj.

Më pas, Igballe Rogova, Drejtoreshë Ekzekutive e RrGGK, njoftoi anëtarët për Dëgjimin Publik që do të mbahet më 12 Qershor lidhur me amandamentimin e projektligjit për statusin dhe të drejtat e martirëve, invalidëve, veteranëve, anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre. Anëtarët e RrGGK-së u inkurajuan që të marrin pjesë në këtë sesion ku aktivistet shpresojnë të amandamentojnë ligjin për të përfshirë gratë që përjetuan dhunë seksuale gjatë luftës.

Naxhije Buçinca, themeluese e [Fondacionit për Edukimin e Vajzave "Çifti Buçinca"](#), shpjegoi këtë Fondacion të ri, që synon të mbështesë edukimin e vajzave. Ata mblodhën 24,000 € gjatë një Mbrëmje Gala, shumë kjo që do të shkojë për [arsimim](#) të vajzave. Kjo përfshinte edhe donacionin në shumë prej 1,000 € të RrGGK.

Zana Hoxha-Krasniqi, Drejtoreshë Ekzekutive e [Artpolis](#) njoftoi lidhur me Festivalin e tyre të Parë për të Drejtat e Njeriut "[Femmes Fatales](#)" ku gratë artiste nga rajoni shfaqën punën e tyre.

Belgjzare Muharremi, nga [Dera e Hapur](#), informoi anëtarët e RrGGK-së për panairin e produkteve të punëdores në Ditën e Prishtinës, më 11 Qershor.

Drita Vukshinaj nga [Shoqata e Femrave me Aftësi të Kufizuara "Femrat për Femra"](#) prezantoi revistën *Gruaja në Fokus*, e publikuar në bashkëpunim të ngushtë me Zyrtaren për Barazi Gjinore të Komunës së Prizrenit dhe OJQ-të tjera të udhëhequra nga gratë. Ajo poashtu njoftoi që Shoqata e Artizanëve do të organizojë një panair më 16 Qershor, në Ditën e Prizrenit.

Aktorja Anisa Ismajli prezantoi projektin e [Qendrës Kosovare për Studime Gjinore \(QKSGj\)](#) dhe Multimedias që po organizohet në shkollë të mesme nëpër Kosovë. Aktorët synojnë të ngrisin vetëdijësimin në mesin e të rinjëve përmes skeçeve të shkurtëra të lidhura me shëndetësinë, barazinë gjinore dhe seksualitetin. Tre aktorë luajtën dy skeçe të shkurtëra lidhur me dhunën në lidhjet e adoleshentëve dhe mungesën e komunikimit në familje.

Emilija Dimoska, përfaqësuese e [KtK në Maqedoni](#) kërkoi mbështetjen e RrGGK-së në refuzimin e amandamentimin e propozuar të ligjit mbi abortimin në Maqedoni. Anëtarët e RrGGK u pajtuan që RrGGK duhet të reagojë dhe mbështesë zgjedhjen e lirë të grave në këtë çështje.



Drita Vukshinaj nga [Shoqata e Femrave me Aftësi të Kufizuara "Femrat për Femra"](#) në Prizren prezantoi revistën "*Gruaja në Fokus*" e publikuar në bashkëpunim me Zyrtaren për Barazi Gjinore dhe organizatat tjera të udhëhequra nga gratë në Prizren.